



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:100578

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05812377

KA.nr.752/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “KGengineering NTSH”, me pronar F.K., kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për mos vlerësim te drejte te gjendjes, jashtë seancës, me datë 29.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HEDHET** padia e paditësit KGengineering NTSH me pronar F.K., kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për mos vlerësim te drejte te gjendjes, **si e paplotësuar**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi KGengineering NTSH me pronar F.K. me datën 25.05.2021 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për shkak të për mos vlerësim te drejte te gjendjes.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, konstatoi se padia e paditësi KGengineering NTSH është e mangët në kuptim objektit të kërkesëpadisë- aktit administrativ të kundërshtuar, e i njëjti nuk e ka shënuar as adresën e selisë ku ushtron veprimtarinë, apo personit të autorizuar.

Duke vepruar konform Nenit 114 të LPK, ku përcaktohet se në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektivit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës, gjykata me datë 14.03.2024 publikoj thirrjen për plotësim të padisë me adresë të saktë të paditësit, konform nenit 99 dhe nenit 253 të LPK dhe për pagesë të taksës e cila qëndroj e publikuar 7 ditë, dhe edhe pas kalimit të afatit prej 8 ditëve gjykata nuk ka pranuar të dhënat e kërkuara e që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës.

Andaj, bazuar në Ligjin për Konfliktet Administrative, nenit 33 nenit 33, Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që: brenda afatit prej tetë (8) ditëve t'i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të cekën udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, dhe Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.

Si rezultat i kësaj, gjykata me datë 04.03.2024 mori aktvendim me të cilin paditësit i'u kthye padia në plotësim, me detyrimin që ta njoftoj gjykatën për adresë të selisë në të cilën ushtron veprimtarinë, dhe atë brenda 8 ditëve nga dita e kalimit të afatit sipas pikës I të këtij aktvendimi ta kthejë padinë e plotësuar, dhe të njëjtën e vendosi në tabelë të shpalljes, ku qëndroj 7 ditë.

Pas kalimit të afatit gjyqësor, gjykata konstatoi se pala paditëse nuk i ka kryer veprimet procedurale si në aktvendimin e datës 04.03.2024. Andaj, gjykata konsideron se nuk ka kushte për shqyrtimin e më tutjeshëm të padisë, dhe vendosi si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.752/22, datë 28.05.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.